



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 korrik 2013
Nr.ref.:AGJ465/13

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI112/12

Parashtrues

Adem Meta

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në
Mitrovicë, Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Adem Meta (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012, dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e kërkon realizimin e së drejtës për kthim në vendin e tij të punës dhe zbatimin në tërësi të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK), si dhe kërkon anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj (Nr. 0242/2011) dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë (Ac. Nr. 61/12), në pjesët ku nuk ishte miratuar kërkesa e tij për kthim në vend të punës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56.1 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.
6. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).
7. Më 13 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, KPMK-në, Komunën e Skenderajt dhe Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë lidhur me regjistrimin e kërkesës.
8. Më 14 mars 2013, Gjykata nga parashtruesi i kërkesës kërkoj informatën lidhur me veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës dhe institucionet përkatëse lidhur me zbatimin e Vendimit të KPMK-së Nr. A 02/200/2011, të 13 shtatorit 2011 dhe të Aktvendimit Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.
9. Më 19 mars 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë: 1. Njoftimin e KPMK-së lidhur me mosekzekutimin e vendimit të KPMK-së dërguar kryeministrit të Republikës së Kosovës më 24 tetor 2011; 2. Njoftimin e KPMK-së lidhur me mosekzekutimin e vendimit të KPMK-së dërguar kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 24 tetor 2011; 3. Raportin me rekomandim nga Avokati i Popullit dërguar kryetarit të Komunës së Skenderajt më 5 nëntor 2012; dhe 4. Përgjigjen e kryetarit të Komunës ndaj Raportit të Avokatit të Popullit më 8 nëntor 2012.

10. Më 5 korrik 2013, pas shqyrtimit të raportit paraprak të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç janë dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës

11. Më 10 maj 2011, udhëheqësi i personelit të Zyrës së kryetarit të Komunës së Skenderajt nxori Vendim (Nr. 118/347) për shuarjen e vendit të punës së zyrtarit profesional të Arkivit Historik në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Skenderajt, funksion i cili ishte ushtruar nga parashtruesi i kërkesës. Vendimi i udhëheqësit të personelit, ndër të tjera, bazohej edhe në Vendimin në funksion të Reformës së Administratës Komunale, Nr. 02-112-333, të nënshkruar nga kryetari i Komunës së Skenderajt, më 5 maj 2011, me të cilin parashihej shuarja e vendit të punës së zyrtarit profesional të Arkivit Historik në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
12. Më 9 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt (Nr. 118-639).
13. Sipas dokumentacionit të bashkëngjitur në kërkesë, ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt nuk kishte nxjerrë ndonjë vendim për ankesën e parashtruesit.
14. Më 8 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në KPM (Nr. 02/200/2011), me pohimin se vendimi për shuarjen e vendit të punës është bërë në kundërshtim me dispozitat e procedurës administrative, dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-149) dhe Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Komunës së Skenderajt, si dhe zbatimin në mënyrë të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kërkon kthimin e tij në vendin e punës dhe kompensimin e pagës, duke filluar nga 1 maj 2011 deri më datën e përmbimit të vendimit.
15. Më 13 shtator 2011, KPM-ja (Vendimi Nr. A 02/200/2011), aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi Vendimin Nr. 118-347 për shuarjen e vendit të punës, të nxjerrë nga udhëheqësi i personelit të Zyrës së kryetarit të Komunës së Skenderajt, dhe e urdhëroi Administratën Komunale të Skenderajt që, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë kompensimin e pagave mujore në mënyrë retroaktive. KPMK-ja më tej deklaroi që vendimi i KPMK-së duhet të zbatohet nga kryetari i Administratës Komunale në Skenderaj dhe udhëheqësi i personelit.
16. Më 11 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për përmbimit të vendimit të KPMK-së në Gjykatën Komunale në Skenderaj.
17. Më 24 tetor 2011, KPMK-ja e informoi kryeministrin lidhur me moszbatimin e vendimit të KPMK-së nga organi i punësimit.

18. Më 8 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Skenderaj, (Vendimi Nr. 0242/2011), ka hedhur poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e vendimit sa i përket kthimit në vendin e punës dhe e ka aprovuar vetëm propozimin për kompensimin e pagave. Gjykata Komunale arsyetoi se “[...] nuk është titull përmbarimor vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për kthimin në vendin e punës”.
19. Më 24 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër vendimit (Nr. 0242/2011) të Gjykatës Komunale në Skenderaj.
20. Më 13 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, Ac. Nr. 61/12, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi në tërësi vendimin e Gjykatës Komunale në Skenderaj. Gjykata e Qarkut konstatoi se përmbarimi i vendimit për kthimin në vend të punës është obligim i institucionit përkatës dhe, në rast të mospërmbarjes së këtij obligimi, është Zyra e Kryeministrit, e cila është përgjegjëse për përmbarimin e tij.
21. Më 5 nëntor 2012, Avokati i Popullit i dërgoi Kryetarit të Komunës së Skenderajt raportin me rekomandim për marrjen e masave për zbatimin e Vendimit A 02/200/2011 të 13 shtatorit 2011 të KPMK-së. Në raportin e Avokatit të Popullit konsiderohej se [...] “Moszbatimi i vendimit administrativ të formës së prerë të KPMKS-së, nga Komuna e Skenderajt përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe zbeh besimin e qytetarëve në zbatimin e drejtësisë dhe shtetin ligjor” [...] dhe i rekomandohej Kuvendit Komunal të Skenderajt që të ndërmarrë masa të menjëhershme për kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e tij të punës, pa ndonjë zvarritje të mëtutjeshme dhe në pajtim me vendimin e KPMK-së.
22. Më 12 nëntor 2012, Kryetari i Komunës së Skenderajt iu përgjigj institucionit të Avokatit të Popullit, duke e informuar se vendimi i KPMK-së ishte nxjerrë në mënyrë të njëanshme, pasi që organi i punësimit nuk ishte njoftuar me ankesën dhe vendimin e lartpërmendur, duke e bërë të pamundur paraqitjen e fakteve nga pala tjetër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut, Ac. Nr. 61/12, i 13 shkurtit 2012, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tij sipas nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] dhe nenit 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë Aktvendimet e Gjykatës Komunale në Skenderaj (Nr. 0242/2011, të 8 nëntorit 2011) dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë (Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012) në pjesën në të cilën kërkesa e tij për kthim në vend të punës nuk është miratuar.

Dispozitat përkatëse ligjore që ndërlidhen me procedurat për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji për procedurën përmbaremore (Ligji Nr. 03/L-008)

25. Neni 1 [Përmbajtja e Ligjit]

“1.1. Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutivë (procedura e përmbaremit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbareimin e vendimit të dhënë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbareimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.”

26. Neni 24, paragrafi 1 [Titulli ekzekutiv]

“ Tituj ekzekutivë janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;*
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;*
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;*
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.”*

27. Neni 26, paragrafi 3 [Përmbareueshmëria e vendimit]

“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbareimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”

28. Neni 294, paragrafi 1 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

“Propozuesi i përmbareimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t’ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbareimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara.”

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

29. Neni 13 [Vendimet e Këshillit]

“Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues, ose personi përgjegjës i

institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të vendimit.”

30. Neni 14 [E drejta e ankesës]

“Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.”

31. Neni 15 [Procedura në rast të moszbatimi të vendimit të Këshillit]

“Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

- 1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njoftojë me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për ekzekutim.*
- 2. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*
- 3. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të fillojë procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas Ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jomateriale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t’ia kompensojë shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.*
- 4. Këshilli duhet të njoftojë me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 32. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.*

33. Në këtë drejtim, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi t’i kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

34. Gjykata konsideron që parashtruesi i kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.
35. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe nenin 47 (2) të Ligjit, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës fillimisht i ka shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, duke vazhduar me ankesën e tij në KPMK, vendimi i të cilit është i formës së prerë në procedure administrative. Po ashtu, ai e ka shfrytëzuar edhe mjetin e fundit juridik në procedurë përmbarimore, që në rastin konkret është Aktvendimi Ac. Nr. 61/12 i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, i 13 shkurtit 2012, ndaj të cilit nuk lejohet ushtrimi i së drejtës për ankesë. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
36. Në lidhje me kriterin sipas të cilit parashtruesi do të duhej ta kishte dorëzuar kërkesën brenda 4 muajve pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë të gjykatës në lidhje me këtë rast, Gjykata konstaton se moszbatimi i vendimit të KPMK-së në lidhje me kthimin në vendin e punës nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktvendimi Ac. Nr. 61/12, i 13 shkurtit 2012) vazhdon edhe sot. Një situatë e ngjashme e moszbatimit të dy vendimeve, të Gjykatës dhe të KPMK-së, ishte paraqitur në një numër të rasteve të tjera në Gjykatën Kushtetuese, në të cilat raste Gjykata ka konfirmuar ekzistencën e situatës së vazhdueshme dhe, me atë rast moszbatimin e afatit të caktuar kohor (Shih rastin nr. *KI08/09, parashtruese Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010, dhe rastin *KI50/12, parashtrues Agush Llluni*, Aktgjykim i 16 korrikut 2012). Prandaj, fakti se parashtruesi nuk e ka dorëzuar kërkesën brenda katër (4) muajsh pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë të gjykatës, është konsideruar jorelevant për shkak të situatës së vazhdueshme. Ky përjashtim është përcaktuar qartë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
37. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës sfidon dështimin e moszbatimit të Vendimit të KPMK-së në tërësi nga gjykatat kompetente. Prandaj, kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit katërmujor nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimit nga autoriteti publik (Shih, *mutatis mutandis, Iatridis kundër Greqisë* Nr. 59493/00, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykim i 19 tetorit 2000). GJEDNJ-ja vëren në mënyrë eksplicite, në një situatë të ngjashme që del në rastin *Iatridis kundër Greqisë*, se rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendim të posaçëm.

38. Lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në nenin 48 të Ligjit, me të cilin parashihet se “*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë*”, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe akte të tjera i janë cenuar, duke cekur aktvendimet e Gjykatës Komunale në Skenderaj (Nr. 0242/2011, të 8 nëntorit 2011) dhe asaj të Qarkut në Mitrovicë (Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012), si akte të autoritetit publik, të cilat i konteston.
39. Duke marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, që ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në Gjykatë brenda afatit juridik si rezultat i gjendjes së vazhdueshme, si dhe që ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë aktvendimet të cilat i konteston, Gjykata vlerëson që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi i aspektit material ligjor të kërkesës

40. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata shqyrton meritat e ankesës së parashtruesit.

I. Në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

41. Parashtruesi ankohet se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

42. Neni 31.1 i Kushtetutës përcakton se:

“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”

43. Gjykata vëren se parashtruesi e konteston Aktvendimin Ac.nr. 61/12 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të 13 shkurtit 2012, derisa është vërtetuar Aktvendimi E. nr. 0242/2011 i Gjykatës Komunale në Skenderaj, i 8 nëntorit 2011, duke e refuzuar propozimin e parashtruesit për përmbartimin e vendimit të KPMK-së në lidhje me kthimin në vendin e tij të punës dhe duke e aprovuar vetëm propozimin për kompensimin e pagave.
44. Gjykata vëren se më 13 shtator 2011, KPMK-ja (Vendimi Nr. A 02/200/ 2011) miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar nga Administrata Komunale në Skenderaj që, në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, të kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë kompensimin e pagave mujore në mënyrë retroaktive. Vendimi i KPMK-së përcaktoi që:

“Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.”

45. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që KPMK-ja është organ i pavarur i themeluar me ligj, në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga vendimi i këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, në të cilat statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i KPMK-së është vendim përfundimtar dhe detyrues, dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të KPMK-së nuk e ndalon përbarimin e vendimit të KPMK-së (Shih rastin *KI 129/11 Viktor Marku*, Aktgjykim i 17 korrikut 2012).
46. Më 13 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Vendimi AC. Nr. 61/12), vërtetoi Aktvendimin E. Nr. 0242/2011 të Gjykatës Komunale në Skenderaj, të 8 nëntorit 2011, lidhur me përbarimin e vendimit të KPMK-së vetëm sa i përket pjesës së kompensimit të pagave. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë shtoi se në pajtim me nenin 24 [Titull ekzekutiv] i Ligjit Nr. 03/L-008 për procedurën përbarimore, pjesa e përbarimit të kthimit të parashtruesit në vendin e punës është obligim i personave përgjegjës të institucionit përkatës dhe në rast të mospërmbushjes së këtij obligimi, është Zyra e Kryeministrit të Kosovës përgjegjëse për përbarimin e vendimit që ka të bëjë me kthim në vend të punës.
47. Në bazë të fakteve të mësipërme, Gjykata vëren që me qëllim të përbarimit të vendimit të KPMK-së, parashtruesi i kërkesës ka bërë përpjekje për shfrytëzimin e të gjitha mjeteve në dispozicion në pajtim me legjislacionin në fuqi, por përkundër përpjekjes së tij, vendimi i KPMK-së nuk është zbatuar nga organet kompetente të Komunës së Skenderajt, e as nga gjykatat kompetente sa i përket pjesës së përbarimit të vendimit për kthimin e tij në vendin e punës.
48. Gjykata vëren se neni 6 i KEDNJ-së gjithashtu zbatohet për procedura administrative që janë brenda kornizës “*për Të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm*”, e drejtë e garantuar gjithashtu me nenin 31 të Kushtetutës.
49. Gjykata konsideron që përbarimi i vendimit përfundimtar dhe të prerë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parimi i lartcekur është i një rëndësie edhe më të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të posaçme për të drejtat civile të palës në kontest. (Shih, *mutatis mutandis*, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafët 40-41).

II. Në lidhje me të drejtën për mjete efektive juridike

50. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet se i është shkelur E Drejta e tij për Mjet Efektiv Ligjor, e garantuar me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës.
51. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] përcakton se:

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

52. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] përcakton se:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

53. Përveç kësaj, neni 13 i KEDNJ-së deklaron se:

Çdo person, të cilit ia kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

54. Gjykata më tej vëren se mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektivë, që do të mundësonin obligimin e organeve përkatëse për përmbarimin me kohë të vendimit të KPMK-së, ngre çështjet e së drejtës për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. Në bazë të këtyre dispozitave, secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj (Shih, *mutatis mutandis*, *Voytenko kundër Ukrainës*, Nr. 18966/02, Aktgjykim i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).

55. Për më tepër, organet kompetente kanë për obligim që ta themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor, edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (Shih rastin *KI50/12, parashtrues Agush Lolluni*, Aktgjykim i 16 korrikut 2012 dhe gjithashtu shih, *mutatis mutandis*, *Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21839/03, GJEDNJ, Aktgjykim i 6 nëntorit 2008).

56. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren që do të ishte e pakuptimtë sikur sistemi juridik i Republikës së Kosovës të lejonte që një vendim përfundimtar gjyqësor të mbetej i paefektshëm në dëm të njëres palë. Interpretimi i neneve të sipërpërmendura ka të bëjë vetëm me qasjen dhe mbrojtjen nga gjykata. Prandaj, mosefikasiteti i procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhon efekte që sjellin në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, një parim, i shprehur qartë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të cilin autoritetet e Kosovës janë të detyruara ta respektojnë (Shih, *mutatis mutandis*, *Romashov kundër Ukrainës*, Nr. 67534/01, Aktgjykim i 27 korrikut 2004).

III. Në lidhje me nenin 21 dhe 49 të Kushtetutës

57. Parashtruesi gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 21 dhe 49 të Kushtetutës.

58. Neni 21 i Kushtetutës i paraqet parimet e përgjithshme që vlejné për të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

59. Neni 49 i Kushtetutës parasheh se:

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

60. Gjykata konsideron se një shkelje e pretenduar e së drejtës për punë nuk është relevante në këtë rast, pasi që moszbatimi në tërësi i vendimit të KPMK-së është një çështje që bie brenda kornizës së të drejtave të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

61. Përfundimisht, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që të merret më tej me pretendime të shkeljes së neneve 21 dhe 49 të Kushtetutës, në veçanti pasi ajo ka gjetur shkelje të neneve përkatëse 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

IV. Përfundim

62. Si përfundim, Gjykata gjen se moszbatimi i tërësisë së vendimit të KPMK-së nga gjykatat e rregullta dhe dështimi i organeve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas për të siguruar zbatimin e vendimeve përkatëse të organeve dhe të gjykatave përbën shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Si rrjedhojë, e drejta për gjykim të drejtë dhe për mjete efektive juridike, e garantuar me nenet e lartcekura, është shkelur dhe se vendimi përfundimtar i KPMK-së duhet të zbatohet në tërësi, ndërsa, për arsyet e parashtruara në paragrafët 60 dhe 61 të këtij aktgjykimi, Gjykata konsideron të panevojshme të merret me pretendimin për shkelje të neneve 21 dhe 49 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 korrik 2013, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së;
- III. TË KONSTATOJË se është e panevojshme të trajtohen pretendimet për shkelje të neneve 21 dhe 49 të Kushtetutës;
- IV. TË KTHEJË Aktvendimin Ac. nr. 06/12, të 13 shkurtit 2012 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj në përputhje me këtë aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj në pajtim me nenin 63 (5) të Rregullores së punës që t'i dorëzojë informata Gjykatës Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- VI. T'U KOMUNIKOHET palëve ky vendim;
- VII. TË PUBLIKOHET ky vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VIII. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

